



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.legjislacionishqiptar.gov.al

Nr.21

2 mars

2007

P Ë R M B A J T J A

Faqe

Dekret nr.5216
datë 21.2.2007

Për lejim lënie të shtetësisë shqiptare 351

Vendim i KM
nr.52, datë 7.2.2007

Për përcaktimin e procedurave dhe të afateve të komunikimit, ndërmjet AKKP-së dhe institucioneve shtetërore, gjatë procesit të njohjes, kthimit apo kompensimit të pronës 352

Vendim i KM
nr.57, datë 7.2.2007

Për ndryshimin e përgjegjësisë së administrimit të sipërfaqes 3575 m², pjesë e pronës nr.177 “Ish-batalion tankesh”, Sauk, Tiranë, nga Ministria e Mbrojtjes të Korporata Elektroenergjetike Shqiptare dhe për një ndryshim në vendimin nr.515, datë 18.7.2003 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Mbrojtjes”... 353

Vendim i KM
nr.62, datë 7.2.2007

Për disa ndryshime në vendimin nr.559, datë 16.8.2006 të Këshillit të Ministrave “Për skemën e shtyrjes së pagesës së TVSH-së për makineritë dhe pajisjet e importuara, si dhe energjinë elektrike, të importuar nga KESH sh.a.” 355

Vendim i KM
nr.66, datë 7.2.2007

Për disa ndryshime në vendimin nr.146, datë 26.2.1998 të Këshillit të Ministrave “Për ndryshimin e tarifave të transportit të udhëtarëve”, të ndryshuar 355

Vendim i KM nr.67, datë 7.2.2007	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarit të pasurisë së paluajtshme, pronë private, e cila preket nga ndërtimi i një kanali, që sistemon ujërat, që dalin nga një tombino në km 29-870, në segmentin rrugor Rrogozhinë-Elbasan	359
Vendim i KM nr.68, datë 7.2.2007	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarit të pasurisë së paluajtshme, pronë private, që preket si rezultat i rrëshqitjes së ndodhur në aksin rrugor Elbasan-Librazhd	360
Vendim i KM nr.69, datë 7.2.2007	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i aksit rrugor, që lidh rrugën kombëtare Gostimë-Mollas me Urën e re mbi lumin Shicë	361
Vendim i KM nr.70, datë 7.2.2007	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i ujësjellësit, Bahçallëk, Shkodër	362
Vendim i KM nr.71, datë 7.2.2007	Për disa ndryshime në vendimin nr.841, datë 13.12.2006 të Këshillit të Ministrave “Për pagesën e anëtarëve në përbërje të komisioneve për vlerësimin, miratimin dhe certifikimin e teksteve shkollore dhe materialeve të tjera ndihmëse, në sistemin arsimor parauniversitar”	363
Vendim i KM nr.76, datë 19.1.2007	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.560, datë 23.10.2000 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e projektit pilot për përfshirjen e spitalit të Durrësit në skemën e sigurimeve të kujdesit shëndetësor”, të ndryshuar	363

DEKRET
Nr.5216, datë 21.2.2007

PËR LEJIM LËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92 pika “c” të Kushtetutës, të neneve 15, 19 dhe 20 të ligjit nr.8389, date 5.8.1998, “Për shtetësinë shqiptare”, bazuar edhe në propozimin e Ministrisë të Brendshme,

DEKRETOJ:

Neni 1

U lejohet lënia e shtetësisë shqiptare me kërkesë të tyre personave të mëposhtëm:

- | | |
|---------------------------------------|---------------------------------------|
| 1. Gent Fiqeret Doda | 27. Alvaro Gëzim Zalla |
| 2. Lorenc Ashim Williams (Ibrahimi) | 28. Alesia Alvaro Zalla |
| 3. Bledi Vasil Dhoska | 29. Raisi Alvaro Zalla |
| 4. Daniel Bledi Dhoska | 30. Vanesa Alvaro Zalla |
| 5. Mentor Barjam Goduni | 31. Zhaneta Teufik Zalla (Haxhijahja) |
| 6. Lulzim Din Stracka (Ismailaj) | 32. Alfons Petraq Fora |
| 7. Feraset Ali Bockstette (Mazreku) | 33. Elona Astrit Duraj |
| 8. Robert Mehmet Kadiu | 34. Genci Halit Minxolli |
| 9. Shkëlqim Gani Lauka | 35. Flamur Abedin Braçe |
| 10. Petrit Xhipe Kapaj | 36. Bylbyl Enver Bokçiu |
| 11. Johanna Petrit Kapaj | 37. Enkeleda Agim Aliu (Bala) |
| 12. Lisetta Petrit Kapaj | 38. Enri Rexhep Aliu |
| 13. Kozeta Rron Kapaj (Bogdo) | 39. Sokol Adem Alimehmeti |
| 14. Artan Selim Shametaj | 40. Evis Spartak Xhamaqi |
| 15. Megi Artan Shametaj | 41. Mustafa Hajdar Nonaj |
| 16. Mirela Faik Shametaj (Kryeziu) | 42. Violeta Ismail Nonaj (Kallulli) |
| 17. Ralf Artan Shametaj | 43. Ilir Mistokli Silo |
| 18. Viktor Hajredin Meidl (Shahinlli) | 44. Edmond Gani Koçja (Kocja) |
| 19. Alketa Osmail Xhemali | 45. Pëllumb Hysen Zenelaj |
| 20. Edmond Sotir Duria | 46. Vinjola Pëllumb Zenelaj |
| 21. Endi Edmond Duria | 47. Albuin Pëllumb Zenelaj |
| 22. David Randolph Edmond Duria | 48. Artemisa Pëllumb Zenelaj |
| 23. Eva Shyqyri Duria (Hoxha) | 49. Valbona Adem Zenelaj (Shafloqi) |
| 24. Bledar Ivan Koli | 50. Taulant Haxhi Vika |
| 25. Klaudio Dashamir Baruti | 51. Erion Pandeli Shoraj |
| 26. Irma Jorgo Karalliu | |

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Alfred Moisiu

VENDIM
Nr.52, datë 7.2.2007

**PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDURAVE DHE TË AFATEVE TË KOMUNIKIMIT, NDËRMJET
AKKP-SË DHE INSTITUCIONEVE SHETËTËRORE, GJATË PROCESIT TË NJOHJES,
KTHIMIT APO KOMPENSIMIT TË PRONËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2 të nenit 15 të ligjit nr.9235, datë 29.7.2004 "Për kthimin dhe kompensimin e pronës", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, në ushtrim të përgjegjësisë të veta, në përputhje me ligjin nr.9235, datë 29.7.2004 "Për kthimin dhe kompensimin e pronës", të ndryshuar, dhe me aktet nënligjore, të dala në zbatim të tij, bashkëpunon me institucionet shtetërore, që kanë në administrim pronën, shtetërore apo publike, apo që kanë të dhëna të nevojshme, për pronën, objekt shqyrtimi.

2. Për vërtetimin e gjendjes, juridike apo fizike, të pronës, konfirmimin e dokumentacionit tekniko-ligjor, si dhe të çdo informacioni tjetër të nevojshëm, AKKP-ja dhe zyrat rajonale të saj, kërkojnë në varësi të objektit të kërkesës/ankesës, i cili do të shërbejë si bazë në përcaktimin e kthimit ose kompensimit të pronës, informacion apo konfirmim, pranë institucioneve të mëposhtme:

- Zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme (ZRPP), për vërtetimin për gjendjen juridike të pronës.

- Këshillit të qarkut (seksioni i administrimit dhe mbrojtjes së tokës), (SAMT), për vërtetimin e gjendjes juridike të sipërfaqeve, që në regjistrin kadastral figurojnë "tokë bujqësore".

- Njësive të qeverisjes vendore, për pronat që i shërbejnë një interesi publik dhe për të cilat bëhet propozimi për tjetërsim.

- Bashkisë (Drejtoria e Përgjithshme e Urbanistikës), komunës, këshillit të qarkut (Drejtoria e Urbanistikës apo njësitë e legalizimit), për konfirmimin e gjendjes së pronës.

- Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës apo organeve në varësi të saj, për pronat e përmbytura nga hidrocentralet dhe nëse pronarët kanë përfituar sipas ligjit për shpronësimet për interes publik.

- Ministrive dhe institucioneve të tjera shtetërore, për pronat të cilat nuk shfrytëzohen për interesa publike.

- Agjencisë së Legalizimit dhe Urbanizimit dhe Integritetit të Zonave Informale.

- Entit Kombëtar të Banesave.

- Ministrisë së Mbrojtjes.

- Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, për pronat e tjera të paluajtshme, përveç tokës bujqësore, të parashikuara në paragrafin e dytë të kësaj pike.

- Arkivit Qendror të Shtetit.

- Drejtorisë së Shërbimit Pyjor (arkivi i kadastrës pyjore), për zërat kadastralë: "Tokë pyjore", "Pyje", "Livadhe" dhe "Kullota".

- Departamentit të shërbimit të tokës dhe ujit, në QTTB, Fushë-Krujë.

- Çdo institucioni tjetër shtetëror, i cili ka në administrim pronën, objekt shqyrtimi apo që mund të japë informacion për të.

3. Kërkesa për marrjen e informacionit paraqitet me shkrim e nënshkruhet nga drejtuesi i AKKP-së dhe i zyrave rajonale.

4. Institucionet, e përmendura në pikën 2 të këtij vendimi, duhet të kthejnë përgjigje, me shkrim, të nënshkruar nga titullari apo, në mungesë të tij, nga zëvendësi, pranë AKKP-së dhe zyrave rajonale, brenda 10 ditëve nga administrimi i kërkesës pranë institucionit të tyre. Në rast të moskthimit të përgjigjes brenda këtij afati, drejtuesi i AKKP-së, njofton, me shkrim, Ministrin e Drejtësisë dhe kabinetin e Kryeministrit.

5. Institucionet përgjegjëse për administrimin apo privatizimin e pronës publike, për objektet shtetërore, për të cilat do të fillojnë procedurat e privatizimit, duhet të vënë në dijeni, paraprakisht, AKKP-në dhe zyrën rajonale në qark, ku ndodhet prona, objekt i privatizimit, e cila duhet të japë përgjigje për pronësinë e tokës, brenda 60 ditëve nga paraqitja e këtij informacioni, për garantimin e ushtrimit të së drejtës së parablerjes nga subjekti i shpronësuar.

6. Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, brenda 60 ditësh nga hyrja në fuqi e këtij

vendimi, vë në dispozicion të AKKP-së hartat e zonave, që kanë përparësi zhvillimin e turizmit, si dhe masterplanet e studimeve të zonave turistike, për një periudhë afatmesme 10-vjeçare.

7. Vendimi nr.330, datë 13.5.2005 i Këshillit të Ministrave "Për sigurimin e të dhënave për pronat, publike dhe private, në funksion të realizimit të procesit të kthimit dhe kompensimit të tyre", shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.57, datë 7.2.2007

**PËR NDRYSHIMIN E PËRGJEGJËSISË SË ADMINISTRIMIT TË SIPËRFAQES 3575 M²,
PJESË E PRONËS NR.177 "ISH-BATALION TANKESH", SAUK, TIRANË, NGA MINISTRIA E
MBROJTJES TE KORPORATA ELEKTROENERGJETIKE SHQIPTARE DHE PËR NJË
NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.515, DATË 18.7.2003 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR
MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE,
TË CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI MINISTRISË SË MBROJTJES"**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13 e 15 shkronja "c" të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 "Për pronat e paluajtshme të shtetit", me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Sipërfaqja 3575 m², pjesë, truall, e pronës nr.177 "Ish-batalion tankesh" Sauk, Tiranë, në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Mbrojtjes, sipas vendimit nr.515, datë 18.7.2003 të Këshillit të Ministrave, të kalojë në përgjegjësi administrimi të Korporatës Elektroenergjetike Shqiptare, për ngritjen e nënstacionit të ri 110/20 kw, për fuqizimin e sistemit elektrik shqiptar.

2. Sipërfaqja 3575 m², pjesë, truall, e pronës nr.177 "Ish-batalion tankesh", Sauk, Tiranë, të hiqet nga lista e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, që i bashkëlidhet vendimit nr.515, datë 18.7.2003 të Këshillit të Ministrave.

3. Korporatës Elektroenergjetike Shqiptare i ndalohet të ndryshojë destinacionin e përdorimit të pronës së përcaktuar në këtë vendim, si dhe ta tjetërsojë ose t'ua japë në përdorim të tretëve.

4. Ngarkohen Ministri i Mbrojtjes, Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Drejtori i Përgjithshëm i KESH-it dhe Kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë të ndjekin procedurat e nevojshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

(për inventarizimin e pronave si klasa të veçanta)

[illegible]

VENDIM
Nr.62, datë 7.2.2007

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.559, DATË 16.8.2006 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR SKEMËN E SHTYRJES SË PAGESËS SË TVSH-SË PËR MAKINERITË
DHE PAJISJET E IMPORTUARA, SI DHE ENERGJINË ELEKTRIKE, TË IMPORTUAR NGA
KESH SHA”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 26 të ligjit nr.7928, datë 27.4.1995 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.559, datë 16.8.2006 të Këshillit të Ministrave, pjesa I, të bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Në pikën 4, paragrafët:

“Personi i tatueshëm importues, për të përfituar nga skema e shtyrjes së pagesës, detyrohet të paraqesë pranë organeve doganore një garanci bankare, shuma e së cilës është e barabartë me shumën e llogaritur të TVSH-së, për importin e makinerive apo të pajisjeve” dhe

“Kjo garanci lirohet nga banka vetëm pasi personi i tatueshëm i paraqet bankës dokumentin e pagesës së TVSH-së, për llogari të degës së doganës përkatëse, dhe konfirmimin, me shkrim, nga kjo degë doganore”, shfuqizohen.

2. Pika 6 shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.66, datë 7.2.2007

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.146, DATË 26.2.1998 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR NDRYSHIMIN E TARIFAVE TË TRANSPORTIT TË UDHËTARËVE”, TË
NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2, 4 e 5 të ligjit nr.7581, datë 7.7.1992 “Për çmimet dhe tarifat”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Financave dhe Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.146, datë 26.2.1998 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të bëhen këto ndryshime:

1. Shkronjat “b” dhe “c” të pikës 1, ndryshohen, si më poshtë vijon:

“b) Tarifat e transportit rrugor ndërqytetës të udhëtarëve me autobus dhe të transportit ujor (liqenor) të jenë sipas përcaktimeve në aneksin 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

c) Tarifat e transportit hekurudhor të udhëtarëve, sipas zonave, të jenë sipas përcaktimeve në aneksin 2, që i bashkëlidhet këtij vendimi.”.

2. Pika 3 shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

ANEKSI 1 PASQYRA nr.1**CMIMET E BILETAVE TE TRANSPORTIT TE UDHETAREVE ME AUTOBUS SIPAS
DISTANCES KILOMETRIKE**

NR.	DISTANCA E LINJES NE KM	CMIMET E BILETAVE PER VAJTJE OSE ARDHJE	
		ISHTE	BEHET
1	2	3	4
1	1 - 12	27	35
2	1 - 17	38	50
3	1 - 22	50	60
4	1 - 27	65	80
5	1 - 32	80	100
6	1 - 37	92	115
7	1 - 42	105	130
8	1 - 47	120	150
9	1 - 52	130	160
10	1 - 57	140	175
11	1 - 62	155	190
12	1 - 67	170	210
13	1 - 72	185	230
14	1 - 77	200	250
15	1 - 82	215	270
16	1 - 87	230	285
17	1 - 92	245	305
18	1 - 97	260	325
19	1 - 102	275	345
20	1 - 112	290	360
21	1 - 122	310	390
22	1 - 132	330	410
23	1 - 142	360	450
24	1 - 152	385	480
25	1 - 162	410	510
26	1 - 172	430	540
27	1 - 182	455	570
28	1 - 192	480	600
29	1 - 202	500	625
30	1 - 212	520	650

1	2	3	4
31	1 - 222	545	680
32	1 - 232	570	710
33	1 - 242	600	750
34	1 - 252	625	780
35	1 - 262	650	810
36	1 - 272	670	840
37	1 - 282	690	860
38	1 - 292	705	880
39	1 - 300	720	900

V.O: Në çmimin e biletës përfshihet edhe TVSH-ja në masën 20%

ANEKSI 1 PASQYRA 2

**ÇMIMET E BILETAVE NE LINJAT E KOMBINUARA ME AUTOBUS – ANIJE NE
LIQENET E DRINIT**

NR	LINJAT	ÇMIMI I BILETES (LEKE)				TOTALI
		ME ANIJE	ME AUTOBUS			
			KOMAN	DUSHAJ	SHUMA	
1	2	3	4	5	6	7
1	Tiranë - B. Curri - Tiranë	240	440	50	490	730
2	Shkodër - B. Curri - Shkodër	240	200	50	250	490
3	Mjedë - B. Curri - Mjedë	240	130	50	180	420

V.O Në çmimin e biletës është përfshirë edhe TVSH-ja në masën 20%.

CMIMET E BILETAVE NE TRANSPORTIN E UDHETAREVE ME HEKURUDHE

ZONA E UDHETIMIT	BILETA VAJTJE		BILETA VAJTJE - KTHIM		ABONE 2- JAVORE		BILETA GJOBE
	PLOTE	50%	PLOTE	50%	STUDENTE	PUNONJES	
I	40	20	70	35	270	340	500
II	55	25	80	40	405	540	500
III	70	35	110	55	565	740	500
IV	85	40	145	70	780	840	500
V	95	55	155	75		1020	500
VI	120	60	192	80		1200	500
VII	130	65	215	105		1380	500
VIII	145	70	230	115		1500	500
IX	160	80	240	220			500
X	190	95	265	130			500
XI	190	95	310	155			500
XII	205	100	325	160			500
XIII	230	115	335	165			500
XIV	240	120	350	175			500
XV	250	125	360	180			500
XVI	265	80					500
XVII	280	140					500
XVIII	295	150					500
XIX	310	155					500
XX	325	160					500
XXI	335	165					500
XXII	355	175					500
XXIII	370	185					500
XXIV	385	190					500
XXV	395	195					500
XXVI	420	210					500

V.O. Ne cmimin e biletave eshte perfshire TVSH-ja ne masen 20% dhe Primi i Sigurimit te detyrueshem te udhetareve.

VENDIM
Nr.67, datë 7.2.2007

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARIT TË PASURISË SË
PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, E CILA PREKET NGA NDËRTIMI I NJË KANALI, QË
SISTEMON UJËRAT, QË DALIN NGA NJË TOMBINO NË KM 29-870, NË SEGMENTIN
RRUGOR RROGOZHINË-ELBASAN**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1, 20 e 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private, për interes publik”, dhe të nenit 8 të ligjit nr.9464, datë 28.12.2005 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2006”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarit të pasurisë së paluajtshme, pronë private, e cila preket nga ndërtimi i një kanali, që sistemon ujërat, që dalin nga një tombino, në km 29-870, në segmentin rrugor Rrogozhinë-Elbasan.

2. Shpronësimi të bëhet në favor të Drejtorisë së Përgjithshme të Rugëve.

3. Pronari i pasurisë së paluajtshme, pronë private, që shpronësohet, të kompensohet në vlerë të plotë, për sipërfaqen 1285 m² tokë/arë, e vlerësuar me 700 lekë/m² dhe kulturë bujqësore, e vlerësuar me 6040 (gjashtë mijë e dyzet) lekë, vlerësuar në shumën e përgjithshme 905 540 (nëntëqind e pesë mijë e pesëqind e dyzet) lekë, sipas tabelës, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

4. Shpenzimet procedurale, në shumën 123 000 (njëqind e njëzet e tre mijë) lekë, të përballohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Rugëve.

5. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, 905 540 (nëntëqind e pesë mijë e pesëqind e dyzet) lekë, të përballohet nga llogaria speciale, e krijuar si transfertë kapitale për t’u përdorur për shpronësimet.

6. Shpronësimi të fillojë e të përfundojë brenda muajit mars 2007.

7. Drejtoria e Përgjithshme e Rugëve të bëjë likuidimin e pronarit brenda afatit të parashikuar në pikën 6 të këtij vendimi.

8. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit dhe Drejtoria e Përgjithshme e Rugëve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

**PRONARI, PASURIA E TË CILIT DO TË SHPRONËSOHET SI REZULTAT I NDËRTIMIT TË NJË
KANALI, QË SISTEMON UJËRAT, QË DALIN NGA NJË TOMBINO NË KM 29-870 NË
SEGMENTIN RRUGOR RROGOZHINË-ELBASAN**

Nr.	Emri	Zona kadastrale	Pasuria	Sipërfaqja tokë arë	Çmimi l/m ²	Vlera në lekë	Kultura jonxhë Vlera në lekë	Vlera totale e shpronësimit
1.	Xhavit Xhemal Ballhysa	1452	104/15 105/3	1285	700	899500	6040	905 540
	Shuma							905 540

Vlera totale e këtij shpronësimi është 905 540 (nëntëqind e pesë mijë e pesëqind e dyzet) lekë.

VENDIM
Nr.68, datë 7.2.2007

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARIT TË PASURISË SË
PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKET SI REZULTAT I RRËSHQITJES SË
NDODHUR NË AKSIN RRUGOR ELBASAN-LIBRAZHD**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1, 20 e 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private, për interes publik”, dhe të nenit 8 të ligjit nr.9464, datë 28.12.2005 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2006”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarit të pasurisë së paluajtshme, pronë private, që preket si rezultat i rrëshqitjes së ndodhur në aksin rrugor Elbasan-Librazhd.
 2. Shpronësimi të bëhet në favor të Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve.
 3. Pronari i pasurisë të paluajtshme, pronë private, që shpronësohet, të kompensohet në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën, që i bashkëlidhet këtij vendimi, për sipërfaqen 385 m² tokë/arë, të vlerësuar me 350 lekë/m², me vlerë të përgjithshme shpronësimi prej 134 750 (njëqind e tridhjetë e katër mijë e shtatëqind e pesëdhjetë) lekësh.
 4. Shpenzimet procedurale, në shumën 133 000 (njëqind e tridhjetë e tre mijë) lekë, të përballohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve.
 5. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, 134 750 (njëqind e tridhjetë e katër mijë e shtatëqind e pesëdhjetë) lekë, të përballohet nga llogaria speciale, e krijuar si transfertë kapitale për t’u përdorur për shpronësimet.
 6. Shpronësimi të fillojë më 1.3.2007 dhe të përfundojë brenda 31.3.2007.
 7. Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve të bëjë likuidimin e pronarit brenda afatit të parashikuar në pikën 6 të këtij vendimi.
 8. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit dhe Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

**PRONARI I PASURISË SË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKET SI REZULTAT I
RRËSHQITJES TË NDODHUR NË AKSIN RRUGOR ELBASAN-LIBRAZHD**

Pronari	Z.K	Nr.pasurisë	Sipërfaqe arë/m²	Çmimi lekë/m²	Vlera në lekë	Vlera totale e shpronësimit
Muharrem Bozhiqi	1063	603/2	385	350	134 750	134 750

Vlera totale e këtij shpronësimi është 134 750 (njëqind e tridhjetë e katër mijë e shtatëqind e pesëdhjetë) lekë.

VENDIM
Nr.69, datë 7.2.2007

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË
PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I AKSIT RRUGOR, QË
LIDH RRUGËN KOMBËTARE GOSTIMË-MOLLAS ME URËN E RE MBI LUMIN SHICË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1, 20 e 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private, për interes publik”, dhe të nenit 8 të ligjit nr.9464, datë 28.12.2005 “Për Buxhetin e Shtetit, të vitit 2006”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajjtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i aksit rrugor, që lidh rrugën kombëtare Gostimë-Mollas me urën e re mbi lumin Shicë.
 2. Shpronësimi të bëhet në favor të Drejtorisë së Përgjithshme të Rugëve.
 3. Pronarët e pasurive të paluajjtshme, pronë private, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, për sipërfaqen 1350 m² tokë/arë, e vlerësuar me 700 lekë/m², dhe kultura/jonxhë, e vlerësuar me 6750 lekë, e vlerësuar në shumën e përgjithshme 951 750 (nëntëqind e pesëdhjetë e një mijë e shtatëqind e pesëdhjetë) lekë, sipas tabelës, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
 4. Shpenzimet procedurale, në shumën 123 000 (njëqind e njëzet e tre mijë) lekë, të përballohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Rugëve.
 5. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 951 750 (nëntëqind e pesëdhjetë e një mijë e shtatëqind e pesëdhjetë) lekësh, të përballohet nga llogaria speciale, e krijuar si transfertë kapitale për t'u përdorur për shpronësime.
 6. Shpronësimi të fillojë e të përfundojë brenda muajit mars 2007.
 7. Drejtoria e Përgjithshme e Rugëve të bëjë likuidimin e pronarëve brenda afatit, të parashikuar në pikën 6 të këtij vendimi.
 8. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit dhe Drejtoria e Përgjithshme e Rugëve për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

**LISTA E PRONARËVE QË DO TË SHPRONËSOHEN SI REZULTAT I LIDHJES SË RRUGËS
NACIONALE GOSTIMË-MOLLAS ME URËN E RE MBI LUMIN SHICË**

Nr.	Emri	Zona kadastrale	Pasuria	Sipërfaqja tokë arë	Çmimi l/m ²	Vlera në lekë	Kultura jonxhë Vlera në lekë	Vlera totale e shpronësimit
1.	Xhevahir Xhevit Gjini	1452	67/84	320	700	224 000	1 600	225 600
2.	Ilmi Agim Cërriku	1452	67/72	460	700	322 000	2 300	324 300
3.	Bashkëpronarët Gjini	1452	67/86	570	700	399 000	2 850	401 850
	Shuma			1 350		945 000	6 750	951 750

Totali: 951 750 lekë.

VENDIM
Nr.70, datë 7.2.2007

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË
PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I UJËSJELLËSIT,
BAHÇALLËK, SHKODËR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1, 20 e 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private, për interes publik", dhe të nenit 8 të ligjit nr.9464, datë 28.12.2005 "Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2006", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i ujësjellësit, Bahçallëk, Shkodër.
 2. Shpronësimi të bëhet në favor të bashkisë së Shkodrës dhe të komunës Bërdicë.
 3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, për sipërfaqen 16 399 m² tokë/arë, e vlerësuar me 830 lekë/m², për shumën e përgjithshme 13 611 170 (trembëdhjetë milionë e gjashtëqind e njëmbëdhjetë mijë e njëqind e shtatëdhjetë) lekë, sipas tabelës, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
 4. Shpenzimet procedurale, në shumën 221 000 (dyqind e njëzet e një mijë) lekë, të përballohen nga bashkia e Shkodrës dhe komuna Bërdicë.
 5. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, 13 611 170 (trembëdhjetë milionë e gjashtëqind e njëmbëdhjetë mijë e njëqind e shtatëdhjetë) lekë, të përballohet nga llogaria speciale, e krijuar si transfertë kapitale për t'u përdorur për shpronësime.
 6. Shpronësimi të fillojë e të përfundojë brenda muajit mars 2007.
 7. Bashkia e Shkodrës dhe komuna Bërdicë të bëjnë likuidimin e pronarëve brenda afatit të parashikuar në pikën 6 të këtij vendimi.
 8. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, bashkia e Shkodrës dhe komuna Bërdicë për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

**LISTA E PRONAREVE QE DO TE SHPRONESOHEN SI REZULTAT I NDERTIMIT TE
UJESJELLESIT BAHÇALLEK SHKODER**

Nr.	EMRI	Zona Kadastrale	Pasuria	Sipërfaqja Tokë are	Cmimi lm2	Vlera në lekë
1.	Kel Nusha Matija	1158	101/20	231	830	191 730
2	Ndreke Nush Matija	1158	101/22	231	830	191 730
3	Lek Pjetër Gjergji	1158	101/16	1851	830	1536330
4	Faik Riza Kasemi	1158	101/8	1388	830	1152040
5	Zef Tish Matja	1158	101/19	925	830	767750
6	Lore Paloke Gjergji	1158	101/18	1851	830	1536330
7	Martin Pashuk Gjergji	1158	101/17	1850	830	1535500
8	Xhemal Kasem Kasemi	1158	101/7	1388	830	1152040
9	Hysen Arif Koburja	1158	101/10	375	830	311250
10	Hysen Arif Koburja	1158	101/4	775	830	643250
11	Jonuz Arif Koburja	1158	101/5	775	830	643250
12	Jonuz Arif Koburja	1158	101/11	375	830	311250
13	Brahim Arif Koburja	1158	101/3	700	830	581000
14	Brahim Arif Koburja	1158	101/9	375	830	311250
15	Rexhep Taruk Velija	1158	101/15	566	830	469780
16	Dul Taruk Velija	1158	101/13	566	830	469780
17	Begir Taruk Velija	1158	101/14	566	830	469780
18	Adem Arif Koburja	1158	101/12	375	830	311250
19	Adem Arif Koburja	1158	101/6	775	830	643250
20	Tonin Nush Matija	1158	101/23	231	830	191730
21	Paulin Nush Matija	1158	101/21	230	830	190900
Shuma				16 399		13 611 170

Totali 13 611 170 lekë

Vlera totale e këtij shpronësimi është 13 611 170 (trembëdhjetë milion e gjashtëqind e njëmbëdhjetë mijë e njëqind e shtatëdhjetë lekë).

VENDIM
Nr.71, datë 7.2.2007

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.841, DATË 13.12.2006 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR PAGESËN E ANËTARËVE NË PËRBËRJE TË KOMISIONEVE PËR
VLERËSIMIN, MIRATIMIN DHE CERTIFIKIMIN E TEKSTEVE SHKOLLORE DHE
MATERIALEVE TË TJERA NDIHMËSE, NË SISTEMIN ARSIMOR PARAUNIVERSITAR”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 9, 52 e 63 të ligjit nr.7952, datë 21.6.1995 “Për sistemin arsimor parauniversitar”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998 “Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit të Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr.841, datë 13.12.2006 të Këshillit të Ministrave, të bëhen këto ndryshime:
 - a) Në pikën 2, pas fjalëve “... jo më shumë se tre persona për secilën kategori vlerësimi...” të shtohen “... duke përjashtuar nga ky rregull pagesën për anëtarët e aktivizuar gjatë vitit 2006...”.
 - b) Pika 4 shfuqizohet.
 2. Efektet financiare të përballohen nga buxheti i miratuar për Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës.
 3. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe Shkencës për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.76, datë 19.1.2007

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR.560, DATË 23.10.2000 TË
KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E PROJEKTIT PILOT PËR PËRFSHIRJEN
E SPITALIT TË DURRËSIT NË SKEMËN E SIGURIMEVE TË KUJDESIT SHËNDETËSOR”,
TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 24 e 36 të ligjit nr.7870, datë 13.10.1994 “Për sigurimet shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të neneve 124 e 128 të ligjit nr.8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e Ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.560, datë 23.10.2000 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të bëhen këto ndryshime e shtesa:

1. Paragrafi i shtatë i pikës 3 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Shpërblimi i punonjësve të bëhet me vendim të këshillit administrativ të ISKSH-së, sipas propozimit të bordit të spitalit të Durrësit”.
 2. Në nenin 12 të statutit, që i bashkëlidhet vendimit, të bëhen shtesa dhe ndryshimi, si më poshtë vijon:
 - a) Pas shkronjës “p” shtohet shkronja “q”, me këtë përmbajtje:

“q) Bordi i propozon këshillit administrativ të ISKSH-së ndryshime në pagat e punonjësve, si dhe shtesat mbi pagë.”.
 - b) Shkronja “i” ndryshohet, si më poshtë vijon:

“i) Miraton mënyrën e përdorimit të të ardhurave.”.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet nga data 13.4.2006.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Abonimet vjetore mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Zhan d'Ark”, prapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", nr.tel: 04 267 468
Çmimi i abonimit për Fletoret Zyrtare 2006 është 16 000 lekë.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

1. KUSHTETUTA E SHQIPËRISË
2. KODET E LEGJISLACIONIT SHQIPTAR
3. REGJISTRAT E NOTERISË
4. PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI:

1. PËR PROKURIMIN PUBLIK (2006).....	1500
2. PËR NËPUNËSIN CIVIL (2005)	600
3. PËR SISTEMIN E DREJTËSISË (Vëllimi i I-rë dhe vëllimi i II-të-2006).....	1300
4. PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI NË FUSHËN E ARSIMIT.....	500

Botime të reja

1 TREGUESI KRONOLOGJIK I LEGJISLACIONIT-2004 (Vëllimi I).....	1000
2 TREGUESI KRONOLOGJIK I LEGJISLACIONIT-2006 (Vëllimi II).....	500
3 TREGUESI TEMATIK I LEGJISLACIONIT-2004 (Vëllimi I).....	1000
4 TREGUESI TEMATIK I LEGJISLACIONIT-2006 (Vëllimi II).....	500
5 PËRMBLEDHJE MARRËVESHJESH NDËRKOMBËTARE NË FUSHËN E DREJTËSISË.....	1000
6 PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR PUSHTETIN VENDOR.....	800
7 PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR NDËRTIMET.....	500
8 PËRMBLEDHJE VENDIMESH UNIFIKUESE TË GJYKATËS SË LARTË (2000-2006).....	1000
9 PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR SHOQËRITË TREGTARE.....	500

Hyri në shtyp më 28.2.2007

Doli nga shtypi më 2.3.2007

Tirazhi: 3500 copë	Formati: 60x88/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja “Grafon”
Tiranë, 2007

Çmimi 16 lekë